


# **RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR**

## **Raporti i Auditimit për Raportet e Financimit të Fushatës Zgjedhore 25 Prill 2021**

### **Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut**



## **I. INFORMACION I PËRGJITHSHËM**

### **A. INFORMACIONI LIGJOR**

#### **i. Kuadri ligjor**

- Ligji nr. 10091, datë 5.03.2009 “Per auditimin ligjor, Organizimin e Profesionit te Ekspertit Kontabel te Regjistruar dhe Kontabilistit te Miratuar” i ndryshuar.
- Standartet Nderkombetare te Auditimit.
- Ligji nr. 10019, date 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikes se Shqiperise”, i ndryshuar.
- Ligjin nr. 8580, date 17.02.2000, "Per partite politike" i ndryshuar.
- Aktet nenligjore te KQZ.
- Vendim Nr. 426, datë 12.07.2021 “Për shpalljen e rezultatit te shortit per emerimin e eksperteve kontabel te licensuar (auditues ligjor) të cilet do te kryejne auditimin e fondeve te perfituara dhe te shpenzuara nga subjektet zgjedhore, per zgjedhjet per kuvendin e Shqiperise te dates 25 prill 2021.

#### **ii. Standardet e kontabilitetit të zbatueshme**

- Ligji Nr.25/2018 “Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

### **B. OBJEKTII AUDITIMIT**

i. Kontrata e shërbimit nr. 6584 prot., date 28.09.2021, me objekt “Kryerja e auditimit te detyrueshem te fondeve te perfituara dhe te shpenzuara gjate fushates zgjedhore per zgjedhjet 2021, te dates 25.04.2021, nga subjektet zgjedhore si edhe kandidatet e listave shumëemerore ne perputhje me ligjin nr.10019, date 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikes se Shqiperise”, i ndryshuar, ligjin nr. 8580, date 17.02.2000, “Per Partite Politike”, i ndryshuar, ligjin nr. 10091, date 05.03.2009 “Per Auditimin Ligjor, Organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe kontabilistit te miratuar”, i ndryshuar, ligjin nr. 25/2018 “Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, si dhe aktet nenligjore te nxjerra per zbatim te tyre.

ii. Vendim Nr. 426, datë 12.07.2021 “Për shpalljen e rezultatit te shortit per emerimin e eksperteve kontabel te licensuar (auditues ligjor) të cilet do te kryejne auditimin e fondeve te perfituara dhe te shpenzuara nga subjektet zgjedhore, per

zgjedhjet per kuvendin e Shqiperise te dates 25 prill 2021.

iii. Përgjegjësitë përkatëse të subjektit zgjedhor dhe audituesit ligjor.

Subjekti zgjedhor është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të të dhënave sipas formatit të standardizuar të raportimit financiar për fushatën zgjedhore, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e raportit financiar që nuk përmban anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të subjektit zgjedhor.

Subjekti zgjedhor duhet të verë në dispozicion të Audituesit Ligjor të gjithë dokumentacionin financiar në lidhje me fushatën zgjedhore të vitit 2021, transaksionet bankare 3 muaj para dhe pas dates së zgjedhjeve dhe çdo informacion tjetër shtesë që Audituesi Ligjor do ta gjykojë të nevojshëm për kryerjen e shërbimit të auditimit. Subjekti zgjedhor duhet të japë Audituesit Ligjor të drejten e hyrjes në të gjitha informacionet e nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare siç janë regjistrimet, dokumentacioni dhe çështje të tjera, si dhe të drejten e komunikimit pa kufizim me personat brenda subjektit zgjedhor nga të cilët gjykohet e nevojshme për të marrë evidence auditimi.

Si pjesë e auditimit, Audituesi kërkon nga subjekti zgjedhor të marrë prej tij konfirmime me shkrim lidhur me paraqitjet që do të behen në lidhje me auditimin.

*Përgjegjësitë e Audituesit*

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat e raportimit financiar për fushatën zgjedhore në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë në vendimet e përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

-Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat e raportimit financiar për fushatën zgjedhore, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidence të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa rreziku që rrjedh nga gabimi, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme,



informacione të deformuara, ose anashkalime të kontrolleve të brendshme.

-Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave të raportimit financiar për fushatën zgjedhore dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

### **c. PREZANTIMI I SUBJEKTIT ZGJEDHOR TEK AUDITUESI LIGJOR**

#### **i. Prezantimi i subjektit zgjedhor**

Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut është themeluar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me urdher nr.6/1, datë 24.02.1992 të Ministrit të Drejtësisë.

Qëllimi dhe objektivat e kësaj Partie janë të percaktuara në program dhe në statutin e saj. Partia e të Drejtave të Njeriut përpaket dhe synon ndërtimin dhe konsolidimin e shtetit të së drejtës, barazisë për të gjithë shtetasit, pa dallime etnike, fetare, gjuhësore, racore dhe krahinore. Ajo mbrohet të drejtat dhe liritë e të gjithë shtetasve dhe, në veçanti, të drejtat e pakicave kombëtare, me të cilat mban marrëdhënie të ngushta dhe bashkërendon veprimtarinë me shoqatat dhe organizatat që përfaqësojnë këto pakica.

Adresa zyrtare e Partisë është: Bulevardi Bajram Curri, Nr.32, Tiranë.

#### **ii. Forma e organizimit dhe menaxhimit**

Organet qendrore të PBDNJ -se janë:

- Kongresi;
- Këshilli i Përgjithshëm Drejtues;
- Kryesia e Përgjithshme

PBDNJ ndërtohet mbi bazën e kriterit territorial. Antaresia e PBDNJ organizohet sipas dy formave organizative: seksioni (organizatat bazë të PBDNJ të cilat përbëhen nga anëtarët e një rajoni të caktuar) dhe dega (degët e PBDNJ krijohen mbi bazën e nënprefekturave).

Organet drejtuese të degëve të Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut janë:

- Konferenca e degës së PBDNJ;
- Këshilli Drejtues i degës së PBDNJ;
- Kryesia e degës së PBDNJ.

Burimet e financimit të Partisë janë:

- Te ardhurat nga kuotat e anetaresimit;
- Te ardhurat nga buxheti i shtetit në përputhje me legjislacionin për financimin e partive politike;
- Ndihmat e anetaresve dhe të perkrahësve të PBDNJ-se;
- Çdo e ardhur tjetër që nuk bie në kundërshtim me legjislacionin për financimin e partive politike.

#### D. PARAQITJA E RAPORTIT DHE STRUKTURA E TIJ

- i. Struktura e raportit të auditimit – kërkesat formale, të ardhurat dhe shpenzimet.
- ii. Gjate procesit të auditimit, audituesi ligjor ka kontaktuar me sekretarin e partise PBDNJ-se, z. Olgert Thomollari, dhe financierin e saj z.Ervin Ziko (vullnetar i jashtëm) te cilet kane dhene informacionet e kerkuara per kryerjen e misionit.
- iii. Partia PBDNJ e ka pergatitur dhe dorezuar raportin e financimit të fushatës zgjedhore në përputhje me kërkesat e raportimit.

#### II. KËRKESAT FORMALE

##### A. PËRMBLEDHJE

1/ Data e dorëzimit			
	a) dorëzim në formë elektronike	Po	21.07.2021
	b) dorëzim fizik	Po	21.07.2021
2/ Nënshkrimi			
	Nënshkrimi	Po	17/06/2021
3/ Llogaria bankare e posaçme/ Personi përgjegjës i financës			
	a) evidenca e hapjes së llogarisë/ve bankare të posaçme	Po	Subjekti zgjedhor PBDNJ ka hapur llogari te posacme bankare per kete fushat zgjedhore, date 08.02.2021 prane Alpha banke
	b) Dokumenti i lëvizjeve në llogarinë/të bankare (bank statement) që mbulon fushatën zgjedhore	Po	01/01/2021- 28/07/2021

c) identiteti i personit përgjegjës  
të financës (financierit)

Po

Ervin Ziko

## B. ANALIZA

### a/ Llogaria bankare e vecantë

- Partia ka llogari bankare te hapur per fushaten zgjedhore ne Alpha banke me nr. llog 902028123003155896.
- Llogaria rrjedhese e Partise nuk eshte perdorur per te marre financime publike dhe per te paguar shpenzimet e fushates.
- Raporti i financimit të fushatës zgjedhore është raportuar me total te ardhura 150.000 leke dhe shpenzime 145.018,50 leke, te ardhurat jane me te medha se shpenzimet, nuk kemi deficit.

#### **Plotesia e informacionit**

- Çelja e llogarisë bankare të posaçme eshte bere ne date 08.02.2021 ne Alpha Banke me nr. llogarie 902028123003155896.
- Levizjet e llogarise që kanë të bëjnë me fushatën zgjedhore jane terhequr nga partia, dhe levizjet fillojne me date 16.04.2021.

### b/ Personi përgjegjës për Financën/ Financieri

#### **Identiteti i personit përgjegjës për financën (Financieri):**

- Personi përgjegjës për thesarin (financat) e partise eshte z. Ervin Ziko, i cili e kryen sherbimin ne menyre vullnetare.
- Nuk ka çeshtje te mosperputhjeve te ndryshme.

#### **Përgjegjësi për përgatitjen dhe nënshkrimin e raportit të financimit të fushatës zgjedhore:**

- Nënshkrimi i raportit të financimit të fushatës zgjedhore eshte bere nga kryetari i partise z. Vangjel Dule date 17.06.2021 dhe pergjegjesi per financat z.Ervin Ziko.
- Përgatitja e të gjithë dokumenteve mbështetëse: zbulimi i problemeve të paraqitjes:

	a) bosh/mungon informacioni	Jo		
	b) dokumentacioni (shqyrtim i shpejtë)			
		<b>Të Ardhurat</b>		
			Financime publike	
			Donacione private	150.000 leke
			Financim nga burimet e veta të partisë Huatë/Kreditë	

		<b>Shpenzimet</b>		
			Mitingje/tubime dhe aktivitete në fushatë	
			Materialet promocionale	72.000 leke
			Media	
			Media Sociale	73.018,50 leke
			Sondazhe	
			Botime/Publikime	
			Shpenzime zyre elektorale	
			Transporti	
			Konsulenca	
			Reklamime në natyre	
	Shpenzime administrative			

### III. TË ARDHURAT

#### A. PËRMBLEDHJE

		Sipas raportit të financimit të fushatës zgjedhore	Sipas auditimit të kryer
<b>1/ Financimi publik</b>			
	Fondi i marrë paradhënie		
	Data e marrjes së fondit		
	Kompensimi financiar paszgjedhor		
	Data e marrjes se kompensimit financiar paszgjedhor		

	Diferenca e kthyer		
	Data e kthimit të diferencës		
<b>2/ Donacionet private</b>			
	Shuma e përgjithshme e raportuar		150.000 leke
	Shuma e donacioneve në para		150.000 leke
	Shuma e donacioneve në natyrë		
	Përgatitet një listë e donatorëve		Vangjel Dule 150.000 leke
	Përfshihen të gjitha dokumentet e lëvizjeve në llogarinë/të bankare të posaçme (bank statement)		Po/ Alpha banke
	Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare të posaçme (bank statement) (shuma)		Po/Alpha banke 150.000 leke
	Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare të posaçme (bank statement) (data)		Po/Alpha banke leke 150.000 date 16.04.2021
	Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare të posaçme (bank statement) (donatori)		Alpha banke Vangjel Dule



	Përputhshmëria mes çdo donacioni në natyrë të raportuar dhe vlerës së tregut (donatori / data)		NA (nuk ka)
	A përputhen shifrat në total (të përgjithshme)?		po
	Respektimi i kufirit të donacionit		po
<b>3/ Financimi nga burimet e vetë partisë</b>			
	Shuma e përgjithshme e raportuar		
	Shuma e përgjithshme e raportuar (Zyra Qendrore)		
	<i>Kuotat e anëtarësisë</i>		
	<i>Botimet</i>		
	<i>Shtypi i printuar</i>		
	<i>Shitja e publikimeve</i>		
	<i>Dhënia me qera</i>		
	<i>Interesa bankare</i>		
	<i>Transferte nga llogaritë e partisë</i>		
	Shuma e përgjithshme e raportuar (degët lokale)		
	<i>Botimet</i>		
	<i>Shtypshkronja</i>		
	<i>Dhënia me qera</i>		
	Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogarinë/të bankare të posaçme (bank statement)(shuma)		
	Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogarinë/të bankare të posaçme(bank statement) (data)		
<b>4/ Huatë/Kreditë</b>			
	Shuma e përgjithshme e raportuar		
	Shuma / shuma e huasë / kredisë (për çdo kredi / hua)		
	Data e huasë / kredisë dhe data e shlyerjes (për çdo kredi / hua)		

Paraqitja e dokumenteve mbështetëse (kontratat për secilën kredi / hua)		
<b>5/ Marrja/Arkëtimi i të ardhurave</b>		
Të gjithë të ardhurat në para të marra / të mbledhura përmes llogarisë specifike.	Po	Nepermjet llogarise se fushates prane Alpha banke

## B. ANALIZA

### a/ Financimi publik

Partia PBDNJ deklaron se nuk ka perftuar asnje fond publik, por ka perftuar donacione private ne shumen 150.000 leke.  
Partia PBDNJ deklaron se per qellime te fushates zgjedhore ka shtypur dhe shperndare materiale publicitare ne shumen 72.000 leke dhe ka shpenzur per media sociale shumen 75.018,50 leke.

### b/ Financimi nga burimet jo publike

- **Donatorët e lejuar:** Donatori i vetem eshte kryetari i partise z. Vangjel Dule me donacion ne shumen 150.000 leke.
- **Burimet e palejuara nuk ka**
- **Kontributet në natyrë nuk ka**

### c/ Financimi nga burimet e vetë partisë politike

- Partia PBDNJ deklaron se nuk ka financime nga burime te brendshme te saj. Ka përputhshmëri mes natyrës dhe shumës së të ardhurave të deklaruar dhe deklarimit bankar .

### d/ Huatë/Kreditë

- PBDNJ deklaron se nuk ka marre kredi

## IV. SHPENZIMET

### A. PËRMBLEDHJE

Shuma e përgjithshme e raportuar	145.018,50 leke	
----------------------------------	-----------------	--

Respektimi i kufirit të shpenzimit		po					
<b>Shpenzimet e kryera nga Zyra Qendrore e partisë</b>							
	Shpenzimet zgjedhore të deklaruar në raportin e financimit të fushatës zgjedhore	Faturat e paraqitura	Faturat e Përgjithshme	Dokumente mbështetëse që mungojnë	Shpenzime të papaguara	Mospërputhje në lidhje me dokumentet e paraqitura nga furnitorët	Shuma e përgjithshme e shpenzimeve zgjedhore sipas auditimit
Mitingjet dhe aktivitetet e fushatës							
Materialet promovuese	72.000 leke	Fat nr.241, dt 20.04.2021 leke 36.000. fat nr.11, dt 21.04.2021 leke 36.000	72.000 leke				72.000 leke
Media/Media Sociale	73.018,50 leke	Fat. Nr.55, dt 24.05.2021 leke 73.018,50	73.018,50 leke				73.018,50 leke
Sondazhet							
Botimet/ Publikimet							
Transporti							
Konsulenca							
Reklammat në natyre							

Shpenzime zyre elektorale dhe Administrative							
<b>Shpenzimet e bëra nga degët e partisë</b>							
	<b>Shpenzimet zgjedhore të deklaruara në raportin e financimit të fushatës zgjedhore</b>	<b>Faturat e paraqitura</b>	<b>Faturat e Përgjithshme</b>	<b>Dokumente mbështetëse që mungojnë</b>	<b>Shpenzime të papaguara</b>	<b>Mospërputhje në lidhje me dokumentet e paraqitura nga furnitorët</b>	<b>Shuma e përgjithshme e shpenzimeve zgjedhore sipas auditimit</b>
Mitingjet dhe aktivitetet e fushatës							
Materialet promovuese							
Media/Media Sociale							
Sondazhet							
Botimet/Publikimet							
Transporti							
Konsulenca							
Reklammat në natyre							
Shpenzime zyre elektorale dhe Administrative							

## Shpenzimet zgjedhore

Të gjitha shpenzimet zgjedhore të bëra janë paguar përmes një llogarie të veçantë

Alpha banke

### **B. ANALIZA**

a/ Respektimi i kufirit të shpenzimeve të fushatës (është çdo shpenzim që bën një parti ose kandidatët e saj për qëllime të fushatë zgjedhore): Eshte respektuar kufiri i shpenzimeve.

b/ Analiza e të gjithë shpenzimeve të deklaruar dhe klasifikuara sipas degës së partisë dhe kategorisë, në përputhje me modelin e raportit të financimit të fushatës zgjedhore.

- Materialet promociionale 72.000 leke.
- Media sociale 73.018,50 leke

### **V. PËRFUNDIMI**

#### **A. SINTEZA**

o Përmbledhja e gjetjeve dhe përfundimeve.

Subjekti zgjedhor PBDNJ ka hapur një llogari të posaçme bankare për fushatën zgjedhore të prillit 2021, referuar nenit 90, pika 2 e Kodit Zgjedhor.

o Lista e parregullsive të gjetura gjatë procesit të auditimit.

Nuk ka patur parregullsi gjatë procesit të auditimit.

o Krahasimi me raportin e monitorimit të ekspertit financiarë?

Ne raportet përfundimtare të monitorimit nuk ka pasur informacion specifik për PBDNJ.

## B. PËRFUNDIMI

### Opinionit pa rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat e raportimit financiar per fushaten zgjedhore per Kuvendin e Shqiperise te dates 25.04.2021, të subjektit zgjedhor Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, PBDNJ, të cilat përfshijnë pasqyrat sipas formatit te standardizuar te raportimit financiar per fushaten zgjedhore me Vendimin nr.13, date 06.04.2021 te Komisionit Rregullator.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat e raportimit financiar per fushaten zgjedhore per Kuvendin e Shqiperise te dates 25.04.2021 paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, financimet dhe shpenzimet e fushates, në përputhje me ligjin nr.10019, date 29.12.2008 per “Kodin Zgjedhor te Republikes se Shqiperise”, i ndryshuar, ligjin nr.8580, date 17.02.2000, “Per Partite Politike”, i ndryshuar dhe Ligjin nr. 25/2018 “Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” si dhe aktet nenligjore te nxjerra per zbatim te tyre.

### Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga subjekti zgjedhor në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave, raporteve financiare, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Aida Maloku  
Auditues Ligjor



Tirane me, 26.10.2021